Allahu nuk e pranon namazin e asnjërit prej jush, nëse e ka prishur abdesin, derisa të marrë sërish

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: "Allahu nuk e pranon namazin e asnjërit prej jush, nëse e ka prishur abdesin, derisa të marrë sërish."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se një nga kushtet e vlefshmërisë së namazit është pastërtia, kështu që, kushdo që dëshiron të falë namaz, duhet të marrë abdes, nëse ka bërë ndonjë veprim që ia prish abdesin, si: jashtëqitja, urina, gjumi etj.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3534